



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council**

<b>DATE:</b>	20.06.2022
<b>REFERENCË:</b>	DPSKPK/Nr. <u>280</u> /2022
<b>PËR:</b>	znj. Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit
<b>CC:</b>	z. Jetish Maloku, Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës
<b>NGA:</b>	Valdrin Krasniqi, U.D. Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës
<b>TEMA:</b>	Plani i veprimit

E nderuar znj. Spanca,

Bazuar në ligjin dhe aktet nënligjore të auditimit, përmes kësaj shkrese, ju lutem gjeni të bashkangjitur planin e zbatimit të rekomandimit të dhënë në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Plani i zbatimit të rekomandimit përfshin të dhënat sipas formës standarde të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Faleminderit për mirëkuptim!

Me respekt,





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Nga: z. Jetish Maloku, Kryesues i Këshillit Prokurorial

**PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE**  
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit	Komente
-----	------------------------------------	--------	-------------	--	-----------------------	---	---------



1	Opiniononi i auditimit- Investimet Kapitale	<p>Në tri raste pagesat në vlerë prej 127,317€ ishin klasifikuar gabimisht, pasi që ishin paguar nga investimet kapitale, mirëpo sipas natyrës i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Pagesat kishin të bënin kryesisht me blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative me vlerë individuale nën 1,000€ ( Kompjuter, Monitor, Laptop, etj.) dhe të njëjtat kishin qenë të buxhetuara në programin për investime kapitale. Kjo kishte ndodhur për shkak se planifikimi i këtyre pajisjeve ishte konsideruar si pjesë e projektit. Shpenzimi i buxhetit të investime kapitale për mallra dhe shërbime, rezulton me një pasqyrë jo të saktë të shpenzimit në PFV. Kjo mbivlerëson kategorinë e investimeve kapitale dhe e nënvlerëson kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.</p>	<p>Kryesuesi i KPK-së, duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim të mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuate për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>Do të bëhet rishikimi i buxhetit të projekteve kapitaleve për vitin 2022.</p> <p>Do të bëhet transferi i mjeteve buxhetore nga kategoria e kapitaleve, përkatësisht nga projekti Pajisjet harduerike dhe softuerike në kategorinë ekonomike të mallrave dhe shërbimeve në kodin përkatës për blerjen e kompjuterëve.</p> <p>Blerja e kompjuterëve dhe pajisje tjera nën 1,000 euro, për këtë vit do të paguhet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve meqë pajisjet mbi 1,000 euro to të mbulohen nga donatorët sipas marrëveshjes.</p>	<p>Udhëheqësit për buxhet dhe financa</p>	<p>Qershor 2022</p>	
---	---	---	---	---	---	---------------------	--